

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit R.V., nga P., R. e M. të Z., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 të KPK-SË, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Pejë - Dega në Deçan, P.nr.95/2015 datë 7.3.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1 nr.837/2017 datë 26.3.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit R.V., paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.837/2017 datë 26.3.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Pejë - Dega në Deçan, P.nr.95/2015 datë 7.3.2017, i dënuari R.V., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit është zëvendësuar me dënimin me gjobë në shumë prej 1500 €, të cilin është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit. Është detyruar që të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 € në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.837/2017 datë 26.3.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.A., avokat nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.nr.106/2018 datë 6.6.2018, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit potencon se aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila shkelje konsiston në atë se të dënuarit R.V., fare nuk i është dorëzuar aktgjykimi i shkallës së parë. Thekson se të dënuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor i është mundësuar përdorimi i gjuhës amtare ashtu siç parashikon neni 14 par.2 të KPPK-së, mirëpo thekson se nuk është vepruar në kuptim me paragrafin 5 të njëjtës dispozitë meqë nuk i është dërguar vendimi gjyqësor i shkallës së parë me arsyetim dhe udhëzim juridik. Potencon se konform kësaj dispozite, të dënuarit duhet t'i sigurohet përkthimi i thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtresave në gjuhën të cilën ai e përdorë kështu që në rastin konkret është shkelur kjo dispozitë. Në vazhdim të kërkesës mbrojtësi i të dënuarit interpreton dispozitën e nenit 478 par.4 të KPPK-së, për të theksuar se në rastin konkret gjykata është dashur që të dënuarit t'ia dorëzoj personalisht vendimin gjyqësor gjë që nuk e ka bërë kurse, nuk e mohon faktin se mbrojtësi aktgjykimin e shkallës së parë e kishte pranuar dhe në afatin ligjor kishte parashtruar edhe mjetin juridik në Gjykatën e Apelit dhe kështu është shkelur neni 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës që ka të bëjë me përdorimin e gjuhës në procedurë dhe neni 6 KEDNJ.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e lartcekura nuk janë të bazuara nga këto arsye:

Edhe pse aktgjykimet kundërshtohen për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kërkesë nuk ka arsyetim se ku konkretisht qëndrojnë këto shkelje ndërsa sa i përket mosdorëzimit të vendimit gjyqësor, nuk ka dhënë arsye se në çfarë mënyre një gjë e tillë ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Vlen të theksohet se siç rezulton nga shkresat e çështjes gjatë gjithë procedurës penale të dënuarit i është ofruar mundësia të cilën ai e ka shfrytëzuar që të përdorë gjuhën e tij amtare, madje, një gjë të tillë as mbrojtësi nuk e ka mohuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Po ashtu, në shkresat e çështjes-procesverbali i shqyrtimit të dytë gjyqësor i datës 4.4.2016 qëndron konstatimi” meqenëse unë jam me banim në M. të Z., dhe kërkon kohë më të gjatë për dërgimin e aktvendimit deri tek unë, tani e kam mbrojtësin tim av. A.A., i cili në momentin që pranon aktvendimin do të më njoftoj mua dhe konsideroj ta kam pranuar personalisht”.

Qëndron fakti se aktgjykimi i shkallës së parë të dënuarit nuk i është dorëzuar personalisht, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi është dorëzuar në përputhje me dispozitën e nenit 478 par.4 të KPPK-së meqë i dënuari ka pasur mbrojtës dhe kështu konsiderohet se dorëzimi ka qenë i rregullt. Nga ana tjetër, ekziston edhe autorizimi i dhënë nga i dënuari në procesverbalin e lartë cekur, që vendimi t’i dorëzohet mbrojtësit të tij. Kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret mosdorëzimi personal të aktgjykimit të shkallës së parë, nuk ka pasur për pasojë humbjen e ndonjë të drejte, respektivisht afatit për ushtrimin e mjetit juridik dhe nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Përkundrazi, aktgjykimin e ka pranuar mbrojtësi i të dënuarit, i cili në afatin ligjor e ka ushtruar ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë, kështu është mbrojtur interesi i të dënuarit në procedurë. Për këto arsye pretendimi në fjalë, rezulton të jetë i pabazuar sepse nuk është cenuar koncepti për ushtrimin e mjetit efektiv juridik të paraparë nga neni 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 13 të KEDNJ.

Pretendimi tjetër se është shkelur dispozita e nenit 14. par.5 të KPPK-së, nuk është i bazuar për faktin se paragrafi 5 i kësaj dispozite, në të cilën thirret mbrojtësi, i referohet personit të arrestuar, që mbahet në paraburgim dhe personit që mbanë dënimin, të cilit duhet siguruar përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtresave në gjuhën të cilin ai e përdorë në procedurë. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një situatë tjetër sepse i dënuari nuk e ka pasur statusin e personit të përcaktuar në këtë dispozitë, i njëjti në procedurë ka përdorur gjuhën e tij amtare, i cili fakt nuk është kontestuar as më këtë mjet juridik.

Nga sa u tha më sipër e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.145/2018, më 18 qershor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta